



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI I LËNDËS
Gjuhë C (nivel i avancuar)

Ngarkesa: 3 kredite (= 30 orë seminar)

Viti / Semestri : Viti I, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave, Përkthim Teknik-letrar dhe Interpretim

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Të përmirësojë aftësitë bazë gjuhësore të studentëve në lexim, dëgjim, të folur dhe shkrim në gjuhën angleze. Të zhvillojë autonominë e të nxënit dhe përdorimin e strategjive efektive për të përvetësuar gjuhën. Të nxisë përdorimin praktik të gjuhës për komunikim të qartë, të rrjedhshëm dhe të saktë në situata të ndryshme.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të zhvillojë aftësitë e leximit të teksteve nga zhanre të ndryshme, duke përfshirë letra, reklama, artikuj dhe pjesë nga letërsia dhe tekste shkencore.
2. Të aftësojë studentët në shkrimin e formave të ndryshme të teksteve si letra familjare, aplikime, artikuj, raporte dhe histori të shkurtra.
3. Të zhvillojë aftësitë e dëgjimit dhe kuptimit të teksteve të ndryshme (mesazhe telefonike, lajme, biseda, pjesë dramatike) për nxjerrjen e informacionit dhe kryerjen e detyrave.
4. Të përmirësojë shprehjen gojore duke përdorur gjuhë të rrjedhshme, të pastër dhe të saktë gramatikisht për diskutime, përshkrime dhe argumentim.

Rezultatet e pritshme:

Në fund të kursit studentët do të jenë në gjendje të

1. Lexojnë dhe kuptojnë idetë kryesore dhe informacionin specifik në tekste nga zhanre të ndryshme.
2. Komunikojnë në mënyrë të kuptueshme me folës vendas dhe japin informacion rreth jetës, interesave dhe përvojave të tyre.
3. Prodhonë tekste të qarta dhe të strukturuar në forma të ndryshme, duke përdorur gramatikën dhe drejtshkrimin e duhur.